

13/10/2017

Nga: Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF)

Për: z. Bajram Kosumi – Drejtor i Departamentit për OJQ në Ministrinë e Administratës Publike

Komentet në lidhje me projekt-ligjin për liri të asociimit në OJQ, të shpallur për konsultim publik me shkrim më datë 19 shtator 2017

Komentet dhe ndryshimet e propozuara më poshtë janë të bazuara në dokumentet vijuese:

- Projektligji për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare, i shpallur për konsultim publik me shkrim më datë 19 shtator 2017 (tutje referuar si “**Projektligji për OJQ**”)
- Ligji Nr. 04/L-57 për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare, i miratuar më 29 gusht 2011 (tutje referuar si “**Ligji për OJQ**”)
- Analiza ligjore dhe e nivelit të zbatimit të Ligjit 04/L-57 për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare, e punuar nga KCSF dhe ECNL në vitin 2015
- Raportet vjetore për Kosovë të Matricës së Monitorimit mbi ambientin e favorshëm për zhvillim të shoqërisë civile të viteve 2013, 2014, 2015 dhe 2016, të botuara nga KCSF dhe BCSDN
- Udhëzuesi i Komisionit të Venedikut mbi lirinë e asociimit, i vitit 2015
- Rekomandimet e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës (CM/Rec(2007)14) mbi statusin ligjor të organizatave jo-qeveritare në Europë, miratuar më 10 tetor 2007 (tutje referuar si “**Rekomandimet e Këshillit të Europës për OJQ**”)
- Konventa Ndërkombëtare mbi të drejtat civile dhe politike (tutje referuar si “**Konventa**”)
- Karta Europiane për të Drejtat e Njeriut (tutje referuar si “**KEDNJ**”)
- Raporti i parë vjetor “Kushtet mbi themelimin e organizatave joqeveritare” i Këshillit të Ekspertëve mbi Legjislacionin për OJQ të Konferencës Plenare të OJQ-ve ndërkombëtare të Këshillit të Europës, i vitit 2009
- Dokumenti “Rregullimi i aktiviteteve politike të organizatave joqeveritare – verzioni i tretë” i Këshillit të Ekspertëve mbi Legjislacionin për OJQ të Konferencës Plenare të OJQ-ve ndërkombëtare të Këshillit të Europës, i vitit 2015
- Raporti i Raportuesit Special mbi të drejtat e lirisë së tubimit paqësor dhe asociimit, prezantuar para Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara më datë 24 prill 2013

1. Përmbledhje e komenteve

Ligji Nr. 05/L-57 për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare (tash e tutje: Ligji për OJQ), i miratuar më 29 gusht 2011, e i cili është në fuqi aktualisht, në përgjithësi është vlerësuar të jetë në përputhje me standardet ndërkombëtare të së drejtës jo-për-përfitim,¹ përkundër mungesës së qartësisë mbi disa elemente që e rregullojnë funksionimin e organizatave joqeveritare në Kosovë. Në anën tjetër, Udhëzimi Administrativ QRK - nr: 02/2014 mbi Regjistrimin dhe Funksionimin e OJQ-ve, i miratuar më 3 shtator 2014, përveç detajizimit të procedurave përkatëse të parapara me Ligjin për OJQ, prezanton edhe dispozita kufizuese mbi suspendimin e OJQ-ve, e të cilat janë në kundërshtim me Ligjin për OJQ.²

Për arsyet e përmendura më sipër, Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF), ka mirëpritur nismën e Ministrisë së Administratës Publike – Departamentit për OJQ (DOJQ – MAP) për të hartuar një ligj të ri mbi lirinë e asociimit në OJQ, dhe ka kontribuar aktivisht përgjatë gjithë procesit. Fillimisht, KCSF në bashkëpunim me Qendrën Europiane për të Drejtën Jopërfëtitim (ECNL), ka përgatitur një analizë të detajuar mbi dispozitat ligjore dhe nivelin e zbatimit të Ligjit për OJQ, analizë të cilën i'a ka dorëzuar zyrtarisht Ministrin për Administratë Publike dhe DOJQ-së në dhjetor 2015. Kjo analizë është shfrytëzuar si dokument kryesor gjatë procesit të hartimit të Koncept Dokumentit për lirinë e asociimit në OJQ, të miratuar në korrik 2016. Pas fillimit të hartimit të Projektligjit për OJQ në shtator 2016, KCSF ka kontribuar aktivisht në kuadër të grupit punues, përsëri në bashkëpunim të ngushtë me ECNL, duke synuar përmirësimin e dispozitave ligjore ekzistuese dhe përfshirjen e parimeve themelore të lirisë së asociimit në kuadër të projektligjit të ri.

KCSF vlerëson që verzioni i Projektligjit për OJQ i publikuar për konsultim publik është dukshëm më i pasur dhe më i qartë në përmbajtje krahasuar me Ligjin aktual për OJQ, dhe si i tillë paraqet një mundësi të mirë për zhvillimin e mëtejshëm të sektorit joqeveritar në Kosovë. Përkundër kësaj, edhe ky verzion ka hapësirë për përmirësim, qoftë në aspektin teknik dhe të qartësisë së dispozitave ligjore, ashtu edhe në kuptim përmbajtësor në trajtimin e çështjeve specifike.

Konkretisht, përveç aspekteve teknike të parashtruara më poshtë në detaje, KCSF kërkon që Projektligji për OJQ të përfshijë edhe çështjet në vijim:

- Të përcaktohet një shumë simbolike minimale për themelimin dhe veprimtarinë e fondacionit
- Të largohet kushtëzimi i ofrimit të shërbimeve nga MAP për OJQ-të të cilat nuk paguajnë gjobat për mosnjohimin me kohë të OJQ-së lidhur me ndryshimet në OJQ
- Të sigurohet pavarësia e OJQ-së në rregulimin e brendshëm, duke mundësuar që kompetenca për emërimin e përfaqësuesit të autorizuar të OJQ-së të mund të delegohet te organet vartëse/të ndërmjetme të OJQ-së
- Të harmonizohet dispozita e ndalesës për OJQ-të që të përkrahin partitë politike ose kandidatët për pozita politike me standardet ndërkombëtare të lirisë së asociimit
- Të shtohet “promovimi i punës vullnetare” në listën e aktiviteteve të kualifikueshme për status për përfitim publik
- Të zgjatet afati për obligimin e OJQ-ve ekzistuese për të harmonizuar statutin e tyre me dispozitat e këtij ligji nga 1 në 2 vite
- Të zgjatet afati për mundësinë e dhënë OJQ-ve ekzistuese për ta ndryshuar formën e organizimit nga shoqata ose fondacioni në institut nga 1 në 2 vite

¹ http://kcsfoundation.org/repository/docs/02_06_2016_9035449_Matrica_e_Monitorimit_2015_per_Kosove_SQ.pdf

² http://kcsfoundation.org/repository/docs/02_06_2016_9035449_Matrica_e_Monitorimit_2015_per_Kosove_SQ.pdf

2. Komentet e veçanta

Propozimet konkrete mbi çështjet e përmendura më sipër janë të shpjeguara më detajisht në pjesën në vijim

a) *Të përcaktohet një shumë simbolike minimale për themelimin dhe veprimtarinë e fondacionit*

Sipas përkufizimit, fondacionet themelohen për menaxhimin e pronave dhe pasurive. Megjithatë, në praktikë janë të pakta ato organizata që veprojnë në përputhje me këtë përkufizim. Rezultatet e anketës së realizuar me fondacione të regjistruara tregojnë se ndonëse një pjesë e madhe e tyre kishin për qëllim menaxhimin dhe shpërndarjen e fondeve në momentin e regjistrimit, shumica dërrmuese e tyre asnjëherë nuk kanë menaxhuar apo shpërndarë ndonjë fond.³ Nga 294 fondacionet e regjistruara deri në vitin 2015, vetëm një është themeluar me kapital fillestar.⁴ Në këtë mënyrë, koncepti i vërtetë i fondacionit, si formë e organizimit të OJQ-ve, është tjetërsuar, si në momentin e regjistrimit ashtu edhe gjatë veprimtarisë së tyre. Arsyet për këtë ndërlidhen kryesisht me legjislacionin e deritashëm që e ka rregulluar regjistrimin dhe veprimtarinë e OJQ-ve në Kosovë.

Sipas neneve 10 dhe 11 të KEDNj-së dhe praktikës gjyqësore të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, qytetarët duhet ta kenë mundësinë për të formuar subjekte juridike për përmbushjen e qëllimeve të tyre sociale. Tri funksionet kryesore të OJQ-ve janë:

- 1) Grumbullimi i kapitalit dhe shpërndarja e donacioneve;
- 2) Aktivitete bazuar në komunitet dhe anëtarësi;
- 3) Ofrimi i shërbimeve ose argumenteve/dijes dhe kryerja e punëve pa fitim.

Është e rëndësishme që të ekzistojnë forma juridike të përshtatshme të cilat i përmbushin nevojat e veçanta financiare dhe udhëheqëse të të gjitha këtyre tri funksioneve. Asnjë prej shteteve, megjithatë, nuk kanë formë juridike ku një funksion i delegohet vetëm një forme juridike. Në shumicën e shteteve europiane, secili funksion mund të ushtrohet përmes më shumë se një forme juridike. Tradicionalisht, forma e fondacionit e përfaqëson funksionin e parë, atë për mbledhje dhe shpërndarje të granteve, me lloje të ndryshme të formave juridike sipas të drejtës zakonore dhe asaj kontinentale (fondacionet, trustet, etj.). Në anën tjetër, forma e shoqatës e përfaqëson funksionin e dytë, atë të bashkimit të anëtarëve dhe përfaqësimit të interesave të tyre të ndërsjella.

Përderisa këto dy funksione janë përmbushur deri më tani nga Ligji për OJQ, përmbushja e funksionit të tretë nuk ka qenë i mundshëm në kuptim të formës juridike të regjistrimit dhe organizimit. Për shkak të kësaj mungese, shumë OJQ të cilat nuk kanë pasur as antarësi e as fonde/kapital për të menaxhuar, janë detyruar të zgjedhin njërin nga format ekzistuese të organizimit. Duke mos e pasqyruar natyrën e vërtetë të tyre, gjatë veprimtarisë së tyre këto OJQ kanë pasur vazhdimisht probleme të natyrave të ndryshme. Pikërisht për këtë arsye KCSF ka propozuar që në Projekligjin për OJQ të përfshihet edhe forma e tretë e regjistrimit dhe organizimit të OJQ-vë, ajo e institutit.

Në mungesë të kësaj alternative, kushtëzimi i themelimit të fondacioneve me kapital fillestar do të mund të konsiderohej si kufizues, duke e vështirësuar kështu themelimin e tyre. Megjithatë, tani që instituti është përfshirë si formë e tretë e organizimit të OJQ-ve, koncepti i fondacionit mund të zbatohet plotësisht, duke e përfshirë edhe obligimin për kapitalin fillestar. Në anën tjetër, për të mos dekurajuar regjistrimin e fondacioneve dhe për të akomoduar natyrën e ndryshme të tyre, shumica minimale për kapitalin fillestar do të duhej të ishte më tepër simbolike, sesa ndonjë shumë e cila ndërlidhet me qëndrueshmërinë e tyre financiare për një kohë më të gjatë.

³ Anketë nga KCSF me fondacionet e regjistruara në Kosovë, qershor-korrik 2015

⁴ Fondacioni i familjes Rizvanolli, i themeluar për shfrytëzimin e trashëgimisë së familjes për ndërtimin e një shkolle fillore

KCSF propozon që në kushtet për regjistrimin e fondacioneve, të shtohet kërkesa për kapital fillestar në shumë prej 500 EUR. Gjithashtu, kjo shumë minimale e kapitalit fillestar duhet të jetë në dispozicion përgjatë gjithë jetës së fondacionit.

- b) Të largohet kushtëzimi i ofrimit të shërbimeve nga MAP për OJQ-të të cilat nuk paguajnë gjokat për mosnjofitimin me kohë të OJQ-së lidhur me ndryshimet në OJQ

Neni 31 i Projektligjit për OJQ përcakton obligimin e OJQ-ve për të informuar DOJQ-në për çfarëdo ndryshimi të rëndësishëm në OJQ brenda 30 ditësh nga dita kur ka ndodhur ndryshimi, duke përcaktuar informatat ndryshimi i të cilave kërkohet të lajmërohet. Për më tepër, ky nen për herë të parë përfshin edhe denimin me gjobë për OJQ-të të cilat dështojnë ta zbatojnë këtë obligim. Gjokat janë simbolike, në vlerë prej 60 EUR për OJQ-në dhe 20 EUR për përfaqësuesin e autorizuar.

KCSF vlerëson që gjokat, si sanksion pasuror, janë masë e mjaftueshme për të arritur qëllimin e synuar, e që është disiplinimi i OJQ-ve që ndryshimet e informatave zyrtare t'i lajmërojnë me kohë në DOJQ. Bazuar në parimin e proporcionalitetit, i cili gjithashtu për herë të parë është përfshirë në kuadër të Projektligjit për OJQ, kushtëzimi i ofrimit të shërbimeve nga MAP me pageën e gjobës mund të jetë kufizim joproporcional.

KCSF propozon që paragrafi 5 i Nenit 31 të Projektligjit për OJQ të largohet në tërësi.

- c) Të sigurohet pavarësia e OJQ-së në rregulimin e brendshëm, duke mundësuar që kompetenca për emërimin e përfaqësuesit të autorizuar të OJQ-së të mund të delegohet te organet vartëse/të ndërmjetme të OJQ-së

Neni 33, paragrafi 4.2 i Projektligjit për OJQ përcakton që organi më i lartë drejtues i OJQ-së mund të delegojë kompetenca tek organet vartëse/të ndërmjetme, me përjashtim të (ndër të tjera) zgjedhjes së përfaqësuesit të autorizuar të OJQ-së. Përderisa organi më i lartë i ka kompetencat e plota në qeverisjen e brendshme të organizatës, përfshirë mundësinë për të zgjedhur përfaqësuesin e autorizuar, një kufizim i tillë është problematik qoftë në aspektin e parimeve ndërkombëtare ashtu edhe në atë praktik, sidomos për OJQ-të e organizuara si shoqata.

Rekomandimet e Këshillit të Europës për OJQ, në pikën 46 të tyre, përcaktojnë që *“Personat përgjegjës për menaxhimin e organizatës së bazuar në anëtarësi (v.j. shoqatës) duhet të zgjedhen ose emërohen nga organi më i lartë udhëheqës ose një organ të cilit i delegohet kjo detyrë. Menaxhimi i organizatave pa anëtarësi (v.j. fondacione dhe institute) duhet të përcaktohet në pajtim me statutin e tyre.”* Ky parim e lejon mundësinë që organi më i lartë, ashtu si e shihet të nevojshme, ta mbajë këtë kompetencë për vete ose t'ia delegojë një organi vartës. Në cilindo opcion, duke qenë organi më i lartë i organizatës, ky i fundit mund ta mbajë në mbikëqyrje apo edhe mund ta tërheqë këtë kompetencë të deleguar në çdo moment.

Në shumicën e rasteve përfaqësuesi i autorizuar është në të njëjtën kohë edhe Drejtori Ekzekutiv i organizatës. Në rastet kur ndodh largimi/zëvendësimi i Drejtorit Ekzekutiv, sipas kësaj dispozite, vetëm Kuvendi i shoqatës mund ta zgjedhë/emërojë Drejtorin e ri Ekzekutiv. Në praktikë, vështirësia e zbatimit të kësaj dispozite është parë te shoqatat me numër të madh të anëtarëve, qoftë persona fizik apo juridik. Për këto shoqata, organizimi i Kuvendit të anëtarëve është mjaft sfidues, si në kuptimin e sigurimit të kuorumit ashtu edhe në aspektin financiar. Kur kanë organe vartëse/të ndërmjetme (p.sh. Bordin), shoqatat e tilla takimin e Kuvendit të anëtarëve e mbajnë zakonisht një herë në vit, ndërsa takimet e organit të ndërmjetëm më shpesh. Zëvendësimi i Drejtorit Ekzekutiv në të shumtën e rasteve është një proces i paplanifikuar shumë kohë më parë, dhe si i tillë, vështirë i përshtatur me kohën e mbajtjes së takimit vjetor të Kuvendit të anëtarëve. Përderisa Kuvendi i anëtarëve, si organi më i lartë udhëheqës, është i thirrur që vazhdimisht të mbikëqyrë punën e organit vartës të radhës, zgjedhja/emërimi i përfaqësuesit të autorizuar nuk do të duhej të ndodhte pa dijeninë e anëtarëve, respektivisht Kuvendit të

anëtarëve. Në rast të çfarëdo pakënaqësie apo problemi, anëtarët mund ta thërrasin Kuvendin e anëtarëve dhe ta trajtojnë problematikën përkatëse, duke e mbajtur përgjegjës organin vartës për vendimin e tyre.

Largimi i këtij kufizimi ligjor nuk e parandalon që në shumicën e rasteve kjo kompetencë të mbetet përsëri në nivel të organit më të lartë udhëheqës, por gjithashtu u'a mundëson atyre shoqatave që e kanë të vështirë zbatimin e saj, ta delegojnë këtë kompetencë te organi vartës.

KCSF propozon që Neni 33, paragrafi 4.2 i Projektligjit për OJQ të largohet në tërësi, ose të paktën për OJQ-të e organizuara si shoqata.

- d) Të harmonizohet dispozita e ndalesës për OJQ-të që të përkrahin partitë politike ose kandidatët për pozita politike me standardet ndërkombëtare të lirisë së asociimit

Neni 35 i Projektligjit për OJQ përcakton që *OJQ-të nuk mund të angazhohen në mbledhje fondesh ose në fushata për të mbështetur partitë politike ose kandidatët për funksione politike dhe as nuk mund të propozojnë, regjistrojnë ose në ndonjë mënyrë të mbështesin kandidatët për poste politike.* Përderisa ky nen ka për qëllim kryesor që të ndalojë OJQ-të që të marrin pjesë në garën zgjedhore, e që është dallimi kryesor në mes të OJQ-ve dhe partive politike, formulimi aktual i këtij neni është në kundërshtim me Rekomandimet e Këshillit të Europës për OJQ dhe praktikën e shumicës së vendeve të rajonit dhe BE-së. Konkretisht pika 13 e Rekomandimit të Këshillit të Europës për OJQ përcakton që *OJQ-të duhet të jenë të lira për të përkrahur një kandidat ose parti të veçantë në zgjedhje ose në një referendum, me kushtin që të jenë transparente në deklarimin e motiveve të tyre. Çfarëdo përkrahje e tillë duhet të jetë gjithashtu në përputhje me legjislacionin mbi financimin e zgjedhjeve dhe partive politike.*

Për më tepër, në Kosovë – sikurse në shumicën e vendeve demokratike – veprojnë organizata të huaja të cilat janë të ndërlidhura me parti politike ose ideologji të caktuara politike (p.sh. fundacione gjermane të spektrit politik socialdemokrat ose kristian demokrat). Këto fundacione, në veprimtarinë e tyre në Kosovë – sikurse në të gjitha vendet tjera ku veprojnë – me veprimtarinë e tyre përkrahin subjekte politike të spektrit të caktuar politik, në funksion të zhvillimit të gjithëmbarshëm të demokracisë në vend. Dispozita aktuale do t'ua pamundësonte një veprimtari të tillë.

KCSF propozon që Neni 35 i Projektligjit për OJQ të ndryshohet si në vijim “OJQ-të nuk mund të angazhohen në mbledhje fondesh për të mbështetur partitë politike ose kandidatët për funksione politike dhe as nuk mund të propozojnë ose regjistrojnë kandidatë për poste politike.

- e) Të shtohet “promovimi i punës vullnetare” në listën e aktiviteteve të kualifikueshme për status për përfitim publik

Neni 38 i Projektligjit për OJQ përcakton një listë të gjerë të aktiviteteve të cilat kualifikohen për Statusin për Përfitim Publik, nëse janë aktivitete parësor i një OJQ-je. Lista e përfshirë në projektligj është më e zgjeruar në krahasim me Ligjin aktual për OJQ. Megjithatë, në të këtij listë mungon vullnetarizmi dhe promovimi i punës vullnetare, si një aktivitet me rëndësi për publikun, e në të cilin angazhohen gjithashtu edhe OJQ-të.

KCSF propozon që në Nenin 38, në listën e aktiviteteve të cilat kualifikohen për Statusin për Përfitim Publik të shtohet edhe aktiviteti “promovimi i punës vullnetare”.

- f) Të zgjatet afati për obligimin e OJQ-ve ekzistuese për të harmonizuar statutin e tyre me dispozitat e këtij ligji nga 1 në 2 vite

Në Kapitullin e dispozitave kalimtare dhe përfundimtar, sipas Nenit 52 paragrafi 2, *OJQ-të e regjistruara në Kosovë obligohen që brenda një (1) viti nga hyrja në fuqi e Projektligjit për OJQ të harmonizojnë statutin e tyre me dispozitat e këtij ligji.* Përderisa kjo dispozitë është e domosdoshme për funksionimin ligjor të të gjitha OJQ-

ve të regjistruara në Kosovë, vlerësojmë që afati prej një viti mund të jetë i pamjaftueshëm për ta arritur qëllimin e dispozitës. Kjo për arsye të shumta, e ndër të tjera për shkak të nevojës që DOJQ dhe partnerët të organizojnë fushata informimi mbi ligjin e ri, komunikim të vazhdueshëm dhe këshillim në interpretimin e duhur të ndryshimeve të nevojshme që duhet të bëhen nga OJQ për ta arritur harmonizimin e nevojshëm.

KCSF propozon që afati në Nenin 52 paragrafi 2 të zgjatet nga një (1) vit në të paktën dy (2) vite.

- g) Të zgjatet afati për mundësinë e dhënë OJQ-ve ekzistuese për ta ndryshuar formën e organizimit nga shoqata ose fondacioni në institut nga 1 në 2 vite

Në Kapitullin e dispozitave kalimtare dhe përfundimtar, sipas Nenit 52 paragrafi 3, *OJQ-të e regjistruara në Kosovë si shoqata apo fondacione, me vendimin e organit më të lartë drejtues, mund të kërkojnë nga DOJQ ndryshimin e formës së organizimit në institut.* Kjo dispozitë mundëson që edhe ato OJQ të cilat janë regjistruar në kohën kur legjislacioni në fuqi nuk e ka njohur formën e organizimit si institut, tani të kenë trajtim të barabartë dhe të kenë mundësi që të shndërrohen në këtë formë të organizimit, nëse organi më i lartë drejtues i tyre e vlerëson që kjo instituti është forma më e përshtatshme për veprimtarinë e tyre. Në anën tjetër, lejimi i ndryshimit të formës vetëm në njërin drejtim (në institut), pa lejuar ndryshime në drejtimet tjera (p.sh. nga shoqata në fondacion dhe anasjelltas, apo të instituteve të reja në format tjera) e mirëmban dallimin e formës së organizimit ndërmjet shoqatave, fondacioneve dhe instituteve.

Megjithatë, afati prej një viti mund të jetë i pamjaftueshëm për ta arritur qëllimin e dispozitës. Kjo për shkak që është e domosdoshme që kjo dispozitë ligjore të rregullohet më detajisht me akt nënligjor, hartimi dhe miratimi i të cilit kërkon kohë. Në mungesë të procedurave të detajuara deri në miratimin e aktit nënligjor përkatës, ky afat prej një viti në praktikë shkurtohet edhe më shumë.

KCSF propozon që afati në Nenin 52 paragrafi 3 të zgjatet nga një (1) vit në të paktën tre (3) vite.

3. Komentet tjera

Në vijim janë të paraqitura komentet tjera të cilat janë të natyrës teknike ose për nevoja të sqarimit të mëtejshëm të dispozitave të ndryshme të Projektligjit për OJQ. Mbi komentet vijuese, është e nevojshme që Projektligji për OJQ të rishikohet dhe lekturohet edhe në aspektin gjuhësor dhe të drejtshkrimit, ndërsa bazuar në verzionin përfundimtar në gjuhën shqipe të kontrollohet edhe saktësia e përkthimit në gjuhën serbe dhe atë angleze.

- Në Nenin 3, paragrafi 1.1, përkufizimi për Organizata Joqeveritare të ndryshohet në: “Organizata Joqeveritare (OJQ) është një person juridik i pavarur dhe jo-për-përfitim, i themeluar për realizimin e qëllimeve të ligjshme për përfitim publik ose interes të ndërsjellë”.
- Në Nenin 3, të shtohet përkufizimi për OJQ-të e vendit të huaja dhe ndërkombëtare, si në vijim: “Organizata Joqeveritare (OJQ) e vendit të huaj apo ndërkombëtare është një subjekt juridik jo-për-përfitim i themeluar jashtë Republikës së Kosovës.”
- Paralelisht me përfshirjen e përkufizimit të OJQ-ve të vendit të huaj dhe ndërkombëtare në Nenin 3, Neni 21, i cili ka përmbajtje shumë të ngjashme me propozimin më sipër, të largohet në tërësi.
- Në Nenin 3, paragrafi 1.5, përkufizimi i termit/shprehjes “Person” të përfshijë edhe “personat pa shtetësi”.
- Në Nenin 3, paragrafi 1.8, përkufizimi i termit/shprehjes “Simbol” të largohet në tërësi, meqenëse kërkesa për simbole është larguar nga kërkesat për regjistrim të OJQ-së.
- Në Nenin 4, paragrafi 3, termi “OJQ” të zëvendësohet me termin “organizatë”, duke e ndryshuar formulimin e paragrafit si në vijim: “Çdo person ka të drejtë të themelojë një organizatë, me ose pa subjektivitet juridik, në pajtim me kushtet dhe rrethanat e përcaktuara me këtë ligj”

- Në Nenin 6, titulli i nenit të ndryshohet si në vijim: “Liria në përcaktimin e fushëveprimtarisë dhe organizimit të brendshëm”, për të reflektuar më saktë përmbajtjen e nenit.
- Në Nenin 6, paragrafi 2, fjalët “të veprojë në nivel lokal, kombëtar ose ndërkombëtar” të zëvendësohen me fjalët “dhe shtrirjen gjeografike të veprimtarisë së saj”.
- Në Nenin 8, pas fjalës “OJQ”, të shtohen fjalët “përfshirë anëtarët apo zyrtarët e saj”.
- Në Nenin 10, për shkak të pamundësisë për ta përkufizuar dhe hapësirës së gjerë për interpretim, të largohet fjala “qartësi”.
- Në Nenin 11, paragrafi 3, të largohet fjala “të arsyeshëm”.
- Në Nenin 12, paragrafi 4, fjalia e dytë që fillon me “Institucionet publike nuk ndërhyjnë...” të shnderrohet në paragraf të ri, pa e ndryshuar përmbajtjen.
- Në Nenin 19, paragrafi 1.1. dhe përgjatë gjithë tekstit të Projektligjit për OJQ, të largohet fjala “simbolin”.
- Në Nenin 19, paragrafët 1.5 dhe 1.6, të qartësohet që informatat përkatëse kërkohen për themeluesit.
- Në Nenin 20, paragrafi 3.9.3 dhe përgjatë gjithë tekstit të Projektligjit për OJQ, fjala “shpërbërje” të zëvendësohet me fjalën “shuarje”.
- Neni 25, paragrafi 1, formulimi të rregullohet si në vijim: “Për ta regjistruar degën e saj në Republikën e Kosovës, OJQ e vendit të huaj ose ndërkombëtare kërkesës për regjistrim i’a bashkëngjijt dokumentet në vijim:”.
- Në Nenin 31, paragrafi 1, pas fjalës “ditësh”, të shtohen fjalët “nga dita e ndryshimit”.
- Në Nenin 32, paragrafi 1.11, pas fjalës “publik”, të shtohen fjalët “nëse ka një të tillë”.
- Në Nenin 39, fjalët “OJQ arsimore dhe shëndetësore” të zëvendësohen me fjalët “OJQ-të me Status për Përfitim Publik në fushën e arsimit ose shëndetësisë”.
- Në Nenin 43, paragrafi 7, referenca “sipas paragrafit 4 dhe 5 të këtij neni” të zëvendësohet me “sipas paragrafit 3 dhe 4 të këtij neni”.

Shënim: Këto komente janë të bazuara në ekspertizën, hulumtimet dhe përvojën shumëvjeçare të KCSF-së në sektorin jo-qeveritar në Kosovë dhe më gjerë, si dhe janë të zhvilluara në konsultim të ngushtë me Qendrën Europiane për të Drejtën Jo-për-përfitim (ECNL), një nga institucionet kryesore të ekspertizës në këtë fushë në Europë.